

VENDIM
Nr.53, datë 23.5.2008

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR DISA NDRYSHIME NË KODIN E
FUNKSIONIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, KODIN E
SISTEMIT TË TRANSMETIMIT, DHE KODIN E MATJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 55 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 18, pika 1, germa “g”, dhe nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.5.2008, pasi u njoh me propozimin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për disa ndryshime në Kodin e Funkcionimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Kodin e Sistemit të Transmetimit dhe Kodin e Matjes së Energjisë Elektrike,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për disa ndryshime në Kodin e Funkcionimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Kodin e Sistemit të Transmetimit dhe Kodin e Matjes së Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, si dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për ndjekjen e procedurave ligjore për miratimin e këtyre akteve.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta